



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:085816

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05474316

C.nr.669/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson G.H. nga Prizreni, kundër të paditurit J.(B) G. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 162.93 euro, më datë 19.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit material, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET i padituri Jeton (Bislim) Gashi nga Prizreni, që paditëses KEDS, t’ia kompensoj dëmin material në shumë prej 162.93 euro, dhe atë me kamatë ligjore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet e këtij kontesti, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KEDS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson G.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padinë, kundër të paditurit J. (B) G. nga Prizreni, me objekt të kontestit kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 162.93 euro.

Paditësja, përmes përfaqësueses së saj, me parashtrësën e datës 11.03.2024, ka theksuar se pasi që me të paditurin më datë 11.01.2024 kanë arritur marrëveshje për kompensimin e dëmit, ndërsa më datë 06.03.2024 ka përmbushur në tërësi obligimin e tij dhe ka bërë pagesën e taksës gjyqësore, heqin dorë nga kërkesëpadia dhe i ka propozuar gjykatës që të merret aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses, në përputhje me nenin 149 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t’i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitës ligjore të paraparë me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:085816
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05474316

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.669/2021, datë 19.03.2024

Gj y q t a r i

Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.